

KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Në Tiranë, sot në datën 16.11.2021 (dymijë e njetzet e një), palët te identifikuar si më poshtë:

Z.Afrim VIGANI, atësia Maz-Har, i datëlindjes 21.10.1958, lindur dhe banues në Tiranë, Njesia Administrative Nr.8, shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID nr.personal F81021056T; referuar me poshte si "DHURUESI;

dhe

Z. Artur ÇANI, atësia Reis, i datelindjes 22.10.1958, lindur dhe banues në Tiranë, Njesia Administrative Nr.5, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Leternjoftimit Nr. personal F81022070N, me poshte referuar si "PRANUESI I DHURIMIT";

MEQENESE EKZISTOJNE KUSHTET

Duke konsideruar faktin, Z.Afrim VIGANI eshte ortak i vetem i shoqerise "WIND ALBANIA" SHPK, shoqeri tregtare e te drejtes Shqiptare, e rregjistruar ne regjistrin tregtar te QKB ne daten 10/09/2021, me numer identifikimi (NUIS) M12110032P dhe zoteron 1 kuote, qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise.

Duke konsideruar faktin qe dhuruesi Z.Afrim VIGANI deshiron t'i dhuroje Z. Artur ÇANI, 50% te kontributeve qe ai zoteron ne shoqerine "WIND ALBANIA" SHPK sipas kushteve te meposhtme.

Duke konsideruar faktin Z. Artur ÇANI deklaroi se pranon dhurimin qe i behet nga Z.Afrim VIGANI, i 50% te kontributeve qe zoteron ne shoqerine "WIND ALBANIA" SHPK.

Palët me vullnet të lirë dhe të plotë redaktuan kete kontratë dhurimi kuotash, me përmbajtje si më poshtë vijon :

Neni 1

Qëllimi i kontratës

- 1.Kjo kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së transferimit të pronësisë nga Dhuruesit, tek Pranuesi i dhurimit.
- 2.Në përcaktim të kushteve, palët konsiderojne të ligjshme përmbajtjen e saj dhe marrin persiper të ekzekutojne veprimet e tyre brenda kushteve të percaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 2

Objekti i kontratës

- 1.Objekti i kesaj kontrate eshte transferimi i pronesise te 1 kuote, qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise "WIND ALBANIA" SHPK nga dhuruesi te pranuesi i dhurimit, dhe pranuesi i dhurimit deklaroi se e pranon ne kete gjendje dhe pa asnje rezerve kete dhurim.
2. Dhurimi i kontributeve të mesiperme nga ortakut ekzistues në favor të ortakut të ri do të bëhet pa kundërshtim, apo detyrim tjetër ligjor.

Neni 3

Pergjegjesite dhe garanci te paleve



Dhuruesi, nepermjet kesaj kontrate, garanton Pranuesin e dhurimit si me poshte:

- a) se kontributet objekt dhurimi jane plotesisht te lira nga çdo barre, apo kufizim i mundshem mbi to dhe personale ne baze te nenit 77 e vijues te Kodit te Familjes ne fuqi;
- b) se miratimi per transferimin e ketyre kuotave ne drejtim te pranuesit te dhurimit eshte marre ne pajtim te plote me ligjin tregtar ne fuqi dhe dispozitat statutore nga organet vendimarrrese te shoqerise;
- c) i ka dhene pranuesit te dhurimit çdo informacion te nevojshem ne lidhje me detyrimet e shoqerise apo pretendime financiare te paleve te treta ndaj shoqerise;

Neni 4

Efektet e kontrates

1. Kjo kontrate ka fuqine e ligjit per palet nga momenti i nenshkrimit te saj.
2. Kontrata ka efekt per palet e treta ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 5

Informacioni konfidencial

Palet detyrohen te mbajne te fshehte te gjitha dokumentacionin, te dhenat dhe cdo informacion tjeter te perfituar gjate marredhenies se tyre ne perputhje me kete kontrate.

Neni 6

Transferimi i te drejtave

1. Menjehere mbas nenshkrimit te paleve, kontrata do te regjistrohet ne regjistrin tregtar per te bere te mundur transferimin e kontributeve ne emer te ortakut te ri Z. Artur ÇANI.
2. Me nenshkrimin e kesaj kontrate, dhuruesi zhvishet teresisht nga kontributet e dhuruara sipas kesaj kontrate si dhe nga çdo e drejte tjeter mbi to, dhe zoteruesi i tyre behet Pranuesi i dhurimit, Z. Artur ÇANI dhe kapitali i shoqerise do te jete i ndare ne 2 kuota, me pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise si me poshte:
 - Z.Afrim VIGANI, zoteron 1 kuote, qe perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise;
 - Z. Artur ÇANI zoteron 1 kuote, qe perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise;

Neni 7

Interpretimi i kontrates

1. Nese do te jete e nevojshme te behet interpretimi i kesaj kontrate, do te synohet te percaktohet se kush ka qene qellimi real dhe i perbashket i te dyja paleve, pa u mbeshtetur ne kuptimin literal te fjaleve, dhe gjithashtu duke vleresuar sjelljen e tyre ne teresi, perpara dhe pas perfundimit te kesaj kontrate.
2. Kushtet e kesaj kontrate do te interpretohen njera pas tjetres, duke dhene seicila kuptimin qe rrjedh nga teresia e kontrates ne fjale. Kontrata do te interpretohet ne konfidence nga palet.

Neni 8

Ligji i aplikueshem dhe Gjykata kompetente

1. Kontrata eshte hartuar dhe interpretuar ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise dhe ligjet tregtare ne fuqi.
2. Dhuruesit dhe Pranuesi i dhurimit angazhohen te bejne cdo perpjekje te zgjidhin mosmarreshjet apo konfliktet e krijuara midis tyre, lidhur me kete kontrate nepermjet negociemeve te drejteperdrejta.
3. Nese palet deshtojne ne zgjidhjen e mosmarreshjeve apo konflikteve midis tyre, ato do ti drejtohen juridiksionit gjyqesor per zgjidhjen e tyre.

Neni 9

Dispozita perfundimtare



Kjo kontrate eshte hartuar ne 2 (dy) kopje, ne gjuhen Shqipe, nga nje per secilen pale, e cila u lexua me ze te larte e te qarte nga palet e mesiperme. Pas leximit, dhe pasi e gjeten kete akt ne perputhje me vullnetin e tyre, e nenshkruan kete akt pa asnje rezerve.

PALËT KONTRAKTORE

DHURUESI

Z.Afrim VIGANI



PRANUESI/I DHURIMIT

Z. Artur ÇANI



